



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Sami Vërbovci B.I." të datës 05.01.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Transporti i nxënësve në Komunën e Prishtinës - Lot 18" me nr. të prokurimit 616-25-10061-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË si e palejuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Sami Vërbovci B.I." të datës 05.01.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Transporti i nxënësve në Komunën e Prishtinës - Lot 18" me nr. të prokurimit 616-25-10061-2-1-1.**
- II. AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Sami Vërbovci B.I." (tutje "parashtruesi") me datë 05.01.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Transporti i nxënësve në Komunën e Prishtinës - Lot 18" me nr. të prokurimit 616-25-10061-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se parashtruesi nuk ka dorëzuar fare ofertë për lotin 18 për të cilën ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Ky fakt nuk kontestohet as nga vet parashtruesi përmes kërkesës për rishqyrtim.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP ku përcaktohet se *“Palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*.

Përmes nenit 59 paragrafit 1 të RRPP është përcaktuar se *“kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, pa pagese, nga cilado palë e interesuar...”*. Në këtë mënyrë është gjetur se nuk janë përmbushur kushtet për të parashtruar kërkesën për rishqyrtim në kuptim të nenit 59 paragrafit 1 të RRPP për shkak se parashtruesi nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur në kundërshtim me nenin 59 par. 1 të RRPP lidhur me nenin 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin b) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin c) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.01.2026



Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.